<p>5.2 brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ndryshimit faktik, në rastin e regjistrimit të ndryshimeve në të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve të detyruar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Mënyra dhe procedura për regjistrimin e të dhënave fillestare për pronarët përfitues</p> <p>1. Regjistrimi fillestar i të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues bëhet nga personi i autorizuar i subjektit të detyruar, i cili duhet të plotësojë dhe të paraqes në ARBK një formular të përgatitur nga ARBK për këtë qëllim, së bashku me një kopje të dokumentit personal të identifikimit të personit të autorizuar.</p> <p>2. ARBK-ja bën një regjistrim në Regjistër dhe publikon informacionin dhe dokumentet sipas paragrafit 2 të nenit 13 të këtij ligji jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga marrja e kërkesës për regjistrim nga subjektet e detyruara.</p> <p>3. Nëse aplikimi për regjistrim është refuzuar për shkak të dështimit të tij për të përmbushur kërkesat e këtij ligji ose një ligji tjetër në fuqi, dhe informacioni nuk mund të regjistrohet dhe publikohet brenda pesë (5) ditëve të punës nga të dhënat e pranuar, ARBK njofton personin e autorizuar për këtë fakt, në përputhje me</p>	<p>5.2 Within 30 calendar days from the date of presentation of the factual amendment, in the case of registration of changes in the data of beneficial owners of obliged entities.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Method and procedure for recording initial data on beneficial owners</p> <p>1. The initial registration of data in the Register of Beneficial Owners shall be done by an authorized person of the obligated entity, who must complete and submit to KBRA a form prepared by KBRA for this purpose, along with a copy of the authorized person's personal identification document.</p> <p>2. KBRA shall make an entry in the Register and shall publish the information and documents in accordance with paragraph 2 of Article 13 of this Law no later than five (5) business days from the receipt of the registration request from the obliged entities.</p> <p>3. If the application for registration is rejected due to its failure to meet the requirements of this Law or another applicable law, and the information cannot be recorded and published within five (5) business days from the data received, KBRA shall notify the authorized person of this fact,</p>	<p>5.2 u roku od 30 kalendarskih dana od dana nastanka činjenične promene, u slučaju evidentiranja promena u podacima stvarnih vlasnika registrovanih subjekata.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Način i postupak evidentiranja početnih podataka o stvarnim vlasnicima</p> <p>1. Početno evidentiranje podataka u Registar stvarnih vlasnika vrši ovlašćeno lice registrovanog subjekta, koje treba popuniti i dostaviti u KARP-u obrazac pripremljen od strane KARP-a u tu svrhu, zajedno sa kopijom lične isprave ovlašćenog lica.</p> <p>2. KARP vrši evidentiranje u Registar i objavljuje informacije i dokumente u skladu sa stavom 2. člana 13. ovog zakona, najkasnije pet (5) radnih dana od prijema zahteva za evidentiranje od strane registrovanih subjekata.</p> <p>3. Ako je podnošenje prijave za evidentiranje odbijeno zbog njegovog neuspeha da ispuni zahteve ovog zakona ili drugog važećeg zakona, i podaci se ne mogu evidentirati i objaviti u roku od pet (5) radnih dana od prijema podataka, KARP obaveštava ovlašćeno lice o ovoj činjenici, u skladu sa</p>
---	---	--

<p>legjislacionin në fuqi dhe do të caktojë një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e lëshimeve.</p> <p>4. Personi i autorizuar duhet të regjistrojë të dhënat fillestare në Regjistrin e Pronarit Përfitues përmes shërbimeve të regjistrimit elektronik siç përcaktohet nga ARBK për zbatimin e këtij ligji.</p> <p>5. Subjektet e detyruar dhe personat e autorizuar janë përgjegjës sipas këtij ligji për vërtetësinë e fakteve, të dhënave të njoftuara dhe dokumenteve përcjellëse, të depozituara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.</p> <p>6. Rregullat për mënyrën dhe arsyet e refuzimit për regjistrim të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve të detyruara përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p>	<p>in accordance with the applicable legislation, and shall set a deadline not exceeding ten (10) business days for the correction of omissions.</p> <p>4.The authorized person must record the initial data in the Register of Beneficial Owners through electronic registration services as determined by KBRA for the implementation of this law.</p> <p>5. The obliged entities and authorized persons shall be responsible under this Law for the accuracy of the facts, information provided, and accompanying documents stored in the Register of Beneficial Owners.</p> <p>6. The rules on the method and reasons for rejection to record data of beneficial owners of obliged entities shall be defined by a bylaw issued by the Ministry.</p>	<p>važećim zakonodavstvom, i odrediće rok od najkasnije deset (10) radnih dana za ispravku propusta.</p> <p>4.Ovlašćeno lice treba da evidentira početne podatke u Registar stvarnih vlasnika putem usluga elektronskog evidentiranja, kako je utvrdila KARP za primenu ovog zakona.</p> <p>5. U skladu sa ovim zakonom, registrovani subjekti i ovlašćena lica su odgovorni za verodostojnost činjenica, prijavljenih podataka i pratećih dokumenata u Registar stvarnih vlasnika.</p> <p>6. Pravila o načinu i razlozi odbijanja evidentiranja podataka o stvarnim vlasnicima registrovanih subjekata utvrđuje ministarstvo podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p style="text-align: center;">Mënyra dhe procedura për përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues në regjistër</p> <p>1.Përditësim ose ndryshim i të dhënave të regjistruara në regjistër bëhet nga:</p> <p>1.1 personi i autorizuar; ose</p>	<p style="text-align: center;">Article 8</p> <p style="text-align: center;">Method and procedure for updating initial data on beneficial owners in the Register</p> <p>1.Updating or amending the data recorded in the Register shall be done by:</p> <p>1.1 The authorized person; or</p>	<p style="text-align: center;">Član 8</p> <p style="text-align: center;">Naćin i postupak za ažuriranje podataka o stvarnim vlasnicima u registar</p> <p>1.Ažuriranje ili promenu evidentiranih podataka u evidenciju vrše:</p> <p>1.1 ovlašćeno lice; ili</p>

<p>1.2 ARBK, bazuar në të dhënat e marra nga autoritetet kompetente, në rastet kur të dhënat e regjistruara në regjistër nuk përputhen me të dhënat në posedim të autoriteteve kompetente.</p> <p>2. Nëse subjekti raportues konstaton se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat e pronarëve përfitues të mbajtura nga subjekti raportues përkatës, atëherë:</p> <p>2.1 subjekti raportues njofton ARBK-në;</p> <p>2.2 pas marrjes së njoftimit nga subjekti raportues, ARBK brenda pesë (5) ditëve të punës publikon njoftimin në regjistër, si dhe njofton me shkrim subjektin e detyruar për mospërputhjen e të dhënave të regjistruara;</p> <p>2.3 subjektet e detyruara brenda dhjetë (10) ditëve pune nga data e njoftimit nga ARBK:</p> <p>2.3.1 përditëson në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, sipas këtij ligji, nëse konstatimi i njësisë raportuese është i saktë, ose;</p> <p>2.3.2 konfirmon në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, të</p>	<p>1.2 KBRA, based on the data received from the competent authorities, in cases when the data recorded in the Register does not correspond with the data in the possession by the competent authorities.</p> <p>2. If a reporting entity finds that the data recorded in the Register of Beneficial Owners does not correspond with the data of beneficial owners, maintained by the relevant reporting entity, then:</p> <p>2.1. The reporting entity shall notify KBRA;</p> <p>2.2. After receiving the notice from the reporting entity, KBRA shall, within five (5) business days publish the notice in the Register, and shall notify in writing the obliged entity of the discrepancies on the data recorded;</p> <p>2.3. The obliged entities shall, within ten (10) business days, from the date of notifying KBRA;</p> <p>2.3.1 Update the data on their beneficial owners in the Register, according to this Law, if the finding of the reporting unit is correct, or;</p> <p>2.3.2 Confirm in the Register the data on their beneficial owners, previously</p>	<p>1.2 KARP, na osnovu podataka dobijenih od strane nadležnih organa, u slučajevima kada se evidentirani podaci u registar ne podudaraju sa podacima koje poseduju nadležni organi.</p> <p>2. Ako subjekat izvestilac utvrdi da se evidentirani podaci u Registru stvarnih vlasnika ne podudaraju sa podacima o stvarnim vlasnicima koje ima relevantni subjekat izvestilac, onda:</p> <p>2.1. subjekat izvestilac obaveštava KARP;</p> <p>2.2. nakon prijema obaveštenja od subjekta izvestioca, KARP u roku od pet (5) radnih dana objavljuje obaveštenje u registar, i takođe pismeno obaveštava registrovani subjekat o nepodudarnosti evidentiranih podataka;</p> <p>2.3. registrovani subjekt u roku od deset (10) radnih dana od dana obaveštenja od strane KARP-a:</p> <p>2.3.1. ažurira u evidenciju podatke o njihovim stvarnim vlasnicima, u skladu sa ovim zakonom, ako je konstatacija izveštajne jedinice tačna, ili;</p> <p>2.3.2. potvrđuje u registar podatke o njihovim stvarnim vlasnicima, koji su</p>
---	--	--

<p>regjistruar më parë, nëse konstatimi i njësisë raportuese nuk është i saktë;</p> <p>2.4në rast se subjekti i detyruar nuk përditëson ose konfirmon të dhënat për pronarët e tyre përfitues brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit nga ARBK, ARBK-ja dhe Departamenti për Organizata Jo-Qeveritare pezullojnë shërbimet e tyre për subjektin e detyruar deri në:</p> <p>2.4.1 kryerjen e përditësimit të të dhënave për pronarët e tyre përfitues në regjistër nëse mos-azhurnimi përbën një shkelje administrative sipas nenit 21; ose</p> <p>2.4.2 konfirmimin në regjistër të të dhënave për pronarët e tyre përfitues, të regjistruar më parë në regjistër.</p> <p>3.ARBK përditëson të dhënat jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga marrja e njoftimit nga personi i autorizuar.</p> <p>4.Personi i autorizuar përditëson të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues përmes shërbimeve të regjistrimit elektronik të përcaktuara nga ARBK-ja për zbatimin e këtij ligji.</p>	<p>recorded, if the finding of the reporting unit is not correct;</p> <p>2.4 In case the obliged entity fails to update or confirm the data on their beneficial owners within 10 calendar days from the date of notification by KBRA, KBRA and the Department for Non-Governmental Organizations shall suspend their services to the obliged entity until:</p> <p>2.4.1 Performing the updating of the data on their beneficial owners in the Register, and shall also impose a fine if the non-updating constitutes an administrative offense under Article 21; or</p> <p>2.4.2 Confirming in the Register, the data on their beneficiary owners, previously recorded in the Register.</p> <p>3.KBRA shall update the data no later than five (5) business days following the receipt of a notice from the authorized person.</p> <p>4.The authorized person shall update the data recorded in the Register of Beneficial Owners through the electronic registration services as determined by KBRA for the implementation of this law.</p>	<p>ranije evidentirani, ako konstatacija izveštajne jedinice nije tačna;</p> <p>2.4. u slučaju da registrovani subjekat ne ažurira ili potvrđuje podatke o njihovim stvarnim vlasnicima u roku od 10 kalendarskih dana od dana obaveštavanja od strane KARP-a, KARP i Odeljenje za nevladine organizacije obustavljaju svoje usluge registrovanom subjektu do:</p> <p>2.4.1 obavljanja ažuriranja podataka o njihovim stvarnim vlasnicima u registar ako neažuriranje predstavlja administrativni prekršaj u skladu sa članom 21; ili</p> <p>2.4.2 potvrđivanje u registar podataka o njihovim stvarnim vlasnicima, koji su ranije evidentirani u registar.</p> <p>3. KARP ažurira podatke najkasnije pet (5) radnih dana od prijema obaveštenja od ovlašćenog lica.</p> <p>4. Ovlašćeno lice ažurira podatke evidentirane u Registar stvarnih vlasnika putem usluga elektronskog evidentiranja utvrđenih od strane KARP-a za primenu ovog zakona.</p>
---	--	--

<p>5.Nëse aplikacioni për ndryshim i personit të autorizuar është refuzuar për shkak të mos-përbushjes së kërkesave të këtij ligji ose një ligji tjetër të zbatueshëm dhe informacioni nuk mund të regjistrohet dhe publikohet brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e të dhënave, ARBK njofton personin e autorizuar për këtë fakt, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe cakton një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e lëshimeve.</p>	<p>5.If the application of the authorized person for amendment is rejected due to failure to meet the requirements of this Law or another applicable law and the information cannot be recorded and published within five (5) business days from receiving the data, KBRA shall notify the authorized person of this fact in accordance with the applicable legislation and shall set a deadline not exceeding ten (10) business days for the correction of omissions.</p>	<p>5. Ako je prijava ovlaštenog lica za promenu odbijena zbog neispunjavanja zahteva ovog zakona ili drugog primenjivog zakona, i podaci se ne mogu evidentirati i objaviti u roku od pet (5) radnih dana od dobijanja podataka, KARP obaveštava ovlašćeno lice o ovoj činjenici, u skladu sa važećim zakonodavstvom na snazi, i određuje rok od najkasnije od deset (10) radnih dana za ispravku propusta.</p>
<p>6.ARBK regjistron të dhënat jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga marrja e njoftimit nga autoritetet kompetente, sipas nën-paragrafit 1.2 të këtij neni.</p>	<p>6.KBRA shall record the data no longer than five (5) business days from receiving the notice from the competent authorities, as defined under subparagraph 1.2 of this Article.</p>	<p>6. KARP evidentira podatke najkasnije pet (5) radnih dana od prijema obaveštenja od nadležnih organa, u skladu sa tačkom 1.2 ovog člana.</p>
<p>7.Rregullat për mënyrën dhe afatet e njoftimit nga autoritetet kompetente, në rastet kur të dhënat e regjistruara në regjistër nuk përputhen me të dhënat që ata disponojnë dhe mënyrën e përditësimit ose ndryshimit nga ARBK, bazuar në njoftimet e mësipërme, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p>	<p>7. The rules regarding the method and deadlines for notification by competent authorities in cases where the data recorded in the Register do not match the data they possess, and the method of updating or amending by KBRA, based on the above-mentioned notifications shall be defined by a bylaw issued by the Ministry.</p>	<p>7. Pravila o načinu i rokovima obaveštavanja od subjekata izvestilaca, u slučajevima kada se evidentirani podaci u registar ne podudaraju sa podacima kojima oni raspolazu i način ažuriranja ili promene od KARP-a, na osnovu gore navedenih obaveštenja, utvrđuje ministarstvo podzakonskim aktom.</p>
<p>8.Rregullat për mënyrën dhe afatet e njoftimit nga subjektet raportuese, në rastet kur të dhënat e regjistruara në regjistër nuk përputhen me të dhënat që ata posedojnë, si dhe mënyra e përditësimit ose konfirmimit të të dhënave të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, bazuar në njoftimet e</p>	<p>8. The rules regarding the method and deadlines for notification by reporting entities in cases where the data recorded in the Register do not match the data they possess, as well as the method of updating or confirming the data of beneficial owners by reporting entities, based on the above-</p>	<p>8. Pravila o načinu i rokovima obaveštavanja od subjekata izvestilaca, u slučajevima kada se evidentirani podaci u registar ne podudaraju sa podacima koje oni poseduju, kao i način ažuriranja ili potvrđivanja podataka o stvarnim vlasnicima od subjekata izvestilaca, na osnovu gore navedenih</p>

<p>mësipërme, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p> <p>9.Vendimet e ARBK-së, sipas këtij ligji, shpallen përmes publikimit në regjistër. Data e njoftimit është data e publikimit në regjistër.</p> <p>10.Rregullat për mënyrën dhe termat e komunikimit ndërmjet Regjistrit të Pronarëve Përfitues, Regjistrit të Shoqërive Tregtare të Kosovës dhe Regjistrit të Organizatave Jo-Qeveritare, për rastet e parashikuara në paragrafin 7 të këtij neni, miratohen nga Ministria e Industrise, Ndermarresise, Tregtise përmes aketve nenligjore.</p>	<p>mentioned notifications, shall be defined by a bylaw issued by the Ministry.</p> <p>9. The KBRA decision, according to this Law, shall be announced through publication in the Register. The date of notification shall be the date of publication in the Register.</p> <p>10. The rules regarding the method and terms of communication between the Register of Beneficial Owners, the Register of Kosovo Business Organizations and the Register of Non-Governmental Organizations, for the cases provided in paragraph 7 of this Article, shall be approved by the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade through bylaws.</p>	<p>obaveštenja, utvrđuje ministarstvo podzakonskim aktom.</p> <p>9. Odluke KARP-a, u skladu sa ovim zakonom, objavljuju se putem objavljivanja u registar. Datum obaveštenja je datum objavljivanja u registar.</p> <p>10. Pravila o načinu i uslovima komunikacije između Registra stvarnih vlasnika, Registra privrednih društava i Registra nevladinih organizacija, za slućajeve propisane u stavu 7. ovog člana, utvrđuje Ministarstvo industrije, preduzetništva i trgovine podzakonskim aktima.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI III</p> <p style="text-align: center;">OBLIGIMET E SUBJEKTEVE TË DETYRUARA DHE PRONARËVE PËRFITUES PËR TË MARRË DHE PËRDITESUAR TË DHËNA PËR PRONARËT PËRFITUES</p> <p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p style="text-align: center;">Obligimet e subjekteve të detyruara për marrjen e të dhënave për pronarët përfitues</p> <p>1. Subjektet e detyruara do të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të identifikuar pronarët e tyre përfitues.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III</p> <p style="text-align: center;">OBLIGATIONS OF OBLIGED ENTITIES AND BENEFICIAL OWNERS TO OBTAIN AND UPDATE DATA ON BENEFICIAL OWNERS</p> <p style="text-align: center;">Article 9</p> <p style="text-align: center;">Obligations of obliged entities to obtain data on beneficial owners</p> <p>1. Obligated entities shall take the necessary actions to identify their beneficial owners.</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE III</p> <p style="text-align: center;">OBAVEZE REGISTROVANIH SUBJEKATA I STVARNIH VLASNIKA DA PRIMAJU I AŽURIRAJU PODATKE O STVARNIM VLASNICIMA</p> <p style="text-align: center;">Član 9</p> <p style="text-align: center;">Obaveze registrovanih subjekata za prijem podataka o stvarnim vlasnicima</p> <p>1. Registrovani subjekti će preduzeti potrebne radnje da bi identifikovali njihove stvarne vlasnike.</p>

<p>2. Bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, nëse subjekti i detyruar e di ose ka arsye për të besuar se një person fizik është ose mund të jetë pronari përfitues i subjektit përkatës të detyruar, ai duhet t'i dërgojë një njoftim personit që:</p> <p>2.1 të deklarojë nëse ai ose ajo është një pronar përfitues në lidhje me subjektin e detyruar, dhe</p> <p>2.2 nëse është kështu, për të konfirmuar ose korrigjuar të dhënat në lidhje me personin në fjale, dhe për të dhënë çdo informacion që mungon.</p> <p>3. Subjektit të detyruar nuk i kërkohet të japë një njoftim të tillë nëse:</p> <p>3.1 tashmë është informuar për statusin e personit si pronar përfitues dhe i janë ofruar të gjitha të dhënat, dhe</p> <p>3.2 informacioni dhe të dhënat janë dhënë nga personi në fjalë ose me njohuritë e tij ose të saj.</p> <p>4. Një subjekt i detyruar gjithashtu mund t'i dërgojë një njoftim një personi sipas këtij neni nëse subjekti i detyruar e di ose ka një arsye të bazuar për të besuar se personi e di identitetin e ndonjë pronari përfitues në lidhje me subjektin përkatës të detyruar, ose e di</p>	<p>2. Pursuant to paragraph 1 of this Article, if the obligated entity becomes aware or has reason to believe that a natural person is or may be a beneficial owner of the relevant obliged entity, it shall serve a notice on the person who shall:</p> <p>2.1 State whether he or she is a beneficial owner in relation to the obliged entity, and</p> <p>2.2 If so, confirm or correct the data related to the person concerned, and provide any missing information.</p> <p>3. The obliged entity shall not be required to provide such a notice if:</p> <p>3.1. It is already informed of the status of the beneficial owner and is provided with all the data, and</p> <p>3.2 Information and data have been provided by the person conceder or to his or her knowledge.</p> <p>4. An obliged entity may also serve a notice on a person under this Article if the obliged entity has become aware or has a justified reason to believe that the person is aware the identity of any beneficial owner in relation to the relevant obliged entity, or is</p>	<p>2. Na osnovu stava 1. ovog člana, ako registrovani subjekt zna ili ima razloga da veruje da fizičko lice jeste ili može biti stvarni vlasnik relevantnog registrovanog subjekta, on treba dostaviti obaveštenje licu da:</p> <p>2.1 izjavljuje da li je on ili ona stvarni vlasnik u vezi sa registrovanim subjektom, i</p> <p>2.2 ako je tako, da bi potvrdio ili ispravio podatke u vezi sa dotičnim licem, da daje informacije koje nedostaju.</p> <p>3. Od registrovanog subjekta se ne traži da izdaje takvo obaveštenje ako:</p> <p>3.1. je već obavešten o statusu lica kao stvarnog vlasnika i pruženi su mu svi podaci, i</p> <p>3.2 je informacije i podatke dao dotično lica ili je on ili ona bila upoznata.</p> <p>4. Registrovani subjekat takođe može dostaviti obaveštenje licu u skladu sa ovim članom ako registrovani subjekat zna ili ima zasnovan razlog da veruje da lice zna identitet nekog stvarnog vlasnika u vezi sa relevantnim registrovanim subjektom, ili zna identitet nekoga koji verovatno zna to.</p>
--	---	---

<p>identitetin e dikujt që ka të ngjarë të ketë atë njohuri.</p> <p>5. Njoftimi, sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të kërkojë nga i adresuari si në vijim:</p> <p>5.1 të deklarojë nëse i adresuari e di apo jo identitetin e çdo:</p> <p>5.1.1 pronari përfitues në lidhje me subjektin përkatës të detyruar, ose</p> <p>5.1.2 personi që ka të ngjarë të ketë atë njohuri, dhe</p> <p>5.2 nëse është kështu, atëherë të sigurojë të gjitha të dhënat e atij personi për të cilat i adresuari ka njohuri dhe të deklarojë nëse të dhënat janë ofruar me ose pa njohuritë e secilit prej personave në fjalë.</p> <p>6. Njoftimi sipas këtij neni duhet të tregojë që i adresuari duhet të veprojë në përputhje me njoftimin jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike nga data e njoftimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Obligimi i subjekteve të detyruara për mbajtjen e regjistrit të pronarëve përfitues</p> <p>1. Subjektet e detyruara krijojnë dhe mbajnë regjistër të brendshëm, të pronarëve përfitues,</p>	<p>aware of the identity of someone likely to have become aware.</p> <p>5. A notice according to paragraph 4 of this Article shall require the addressee as in the following:</p> <p>5.1 State whether or not the addressee is aware of the identity of any:</p> <p>5.1.1 beneficial owners related to the relevant obliged entity, or</p> <p>5.1.2 any person who is likely to have been aware, and</p> <p>5.2 if so, then he/she shall provide all data of such person of which the addressee has become aware of and shall state whether the data was provided with or without the knowledge of each of the persons concerned.</p> <p>6. The notice under this Article shall indicate that the addressee must act in accordance with the notice no later than ten (10) calendar days from the date of the notice.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Obligation of obliged entities to maintain a Register of Beneficial Owners</p> <p>1. Obligated entities shall create and maintain an internal Register of Beneficial Owners,</p>	<p>5. Obaveštenje, u skladu sa stavom 4. ovog člana, treba da traži od adresiranog, kao u nastavku:</p> <p>5.1. da izjavi da li adresirani zna ili ne zna identitet svakog:</p> <p>5.1.1. stvarni vlasnik u vezi sa relevantnim registrovanim subjektom, ili</p> <p>5.1.2. lice koje verovatno zna to, i</p> <p>5.2. ako je tako, onda obezbediti sve podatke o tom licu za koje adresirani zna i da izjavljuje ako su podaci pruženi sa ili bez znanja svakog od dotičnih lica.</p> <p>6. Obaveštenje, u skladu sa ovim članom, treba pokazati da adresirani treba da postupa u skladu sa obaveštenjem najkasnije deset (10) kalendarskih dana od dana obaveštenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Obaveza registrovanih subjekata za vodenje registra stvarnih vlasnika</p> <p>1. Registrovani subjekti kreiraju i vode interni registar stvarnih vlasnika, koji sadrži</p>
---	---	---

<p>që përmban të dhëna adekuate, të sakta dhe të përditësuara dhe dokumente përcjellëse, në bazë të të cilave përcaktohet pronari përfitues i subjektit dhe lloji i kontrollit që ata ushtrojnë.</p> <p>2. Të dhënat e pronarëve përfitues duhet të mbahen në zyrën e subjektit përkatës të detyruar, ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë për të cilin ARBK-ja dhe Departamenti i Organizatave Jo-Qeveritare janë të njoftuar, si dhe të jenë të aprovuara me shkrim nga subjekti i detyruar.</p> <p>3. Të dhënat e detyrueshme të pronarit përfitues që regjistrohen në regjistrin e pronarëve përfitues duhet të jenë të njëjta me ato të parashikuara në nën-paragrafët 1.2 deri 1.5 të nenit 5 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Obligimi për përditësimin e të dhënave për pronarët përfitues</p> <p>1. Nëse subjekti i detyruar e di ose ka arsye për të besuar se është shfaqur një ndryshim relevant në lidhje me një pronar përfitues të regjistruar në regjistrin e pronarëve përfitues, ai duhet t'i dërgojë një njoftim për personin në fjalë:</p> <p>1.1 për të konfirmuar nëse ka ndodhur apo jo ndryshimi, dhe</p>	<p>which shall contain adequate, accurate and updated data and supporting documents, based on which the beneficiary owner of the entity and the type of control they exercise are defined.</p> <p>2. The data of the beneficial owners shall be kept in the office of the relevant obliged entity, or in any other place in Kosovo of which KBRA and the Department of Non-Governmental Organizations are notified, and shall be approved in writing by the obliged entity.</p> <p>3. The mandatory data of the beneficial owner to be recorded in the Register of Beneficial Owners shall be the same as those provided for in sub-paragraphs 1.2 to 1.5 of Article 5 of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Obligation to update data on beneficial owners</p> <p>1. If the obliged entity is aware or has reasons to believe that a relevant amendment has occurred in relation to a beneficial owner recorded in the Register of Beneficial Owners, it shall serve a notice on the person concerned to:</p> <p>1.1 Confirm whether or not the amendment has occurred, and</p>	<p>adekvatne, tačne i ažurirane podatke i prateće dokumente, na osnovu kojih se utvrđuje stvarni vlasnik subjekta i vrsta kontrole koju oni vrše.</p> <p>2. Podaci o stvarnim vlasnicima treba da se drže u kancelariji relevantnog registrovanog subjekta, ili na nekom drugom mestu na Kosovu za koje su KARP i Odeljenje za nevladine organizacije obavešteni, kao i da su pismeno odobreni od registrovanog subjekta.</p> <p>3. Obavezni podaci stvarnog vlasnika koji se evidentiraju u registar stvarnih vlasnika treba da budu isti sa podacima propisanim tačkom 1.2 do 1.5 člana 5. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Obaveza ažuriranja podataka o stvarnim vlasnicima</p> <p>1. Ako registrovani subjekat zna ili ima razloga da veruje da je nastala relevantna promena u vezi sa stvarnim vlasnikom evidentiranog u registar stvarnih vlasnika, on treba dotičnom licu dostaviti obaveštenje:</p> <p>1.1. da potvrdi da li se desila promena ili ne, i</p>
--	---	---

<p>1.2 nëse ka ndodhur ndryshimi, të deklaroj datën e ndryshimit, dhe të konfirmoj ose korigjoj të dhënat e kërkuara të përfshira në njoftim, dhe për të ofroj çdo informacion që mungon.</p> <p>2.Një ndryshim relevant në lidhje me personin ndodh nëse:</p> <p>2.1personi pushon së qeni pronar përfitues në lidhje me një subjekt përkatës të detyruar, ose</p> <p>2.2ndodh ndonjë ndryshim tjetër, si rezultat i të cilit të dhënat e detyrueshme për pronësinë përfituese sipas nën-paragrafëve 1.2 deri 1.5 të nenit 5 të këtij ligji janë bërë të pasakta ose jo të plota.</p> <p>3.Subjekti i detyruar nuk është i obliguar të japë një njoftim sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse:</p> <p>3.1.tashmë është informuar për ndryshimin relevant dhe janë ofruar të gjitha të dhënat në nën-paragrafin 1.2 të këtij neni, dhe</p> <p>3.2.informacioni dhe të dhënat janë dhënë nga personi në fjalë ose me njohuritë e tij ose të saj.</p> <p>4.Subjekti i detyruar duhet të dërgojë një njoftim sipas paragrafit 1 të këtij neni sa më</p>	<p>1.2 state, if the amendment has occurred, the date of amendment and confirm or correct the required data included in the notice, and provide any missing information.</p> <p>2. A relevant amendment related to the person shall take place if:</p> <p>2.1 The person ceases to be the beneficial owner related to a relevant obliged entity, or</p> <p>2.2 Another amendment takes place, as a result of which the mandatory data of beneficial ownership according to sub-paragraphs 1.2 to 1.5 of Article 5 of this Law have become incorrect or incomplete.</p> <p>3. The obliged entity shall not be obliged to provide a notice according to paragraph 1 of this Article if:</p> <p>3.1. It has already been informed of the relevant amendment and provided with all data referred to in sub-paragraph 1.2 of this Article, and</p> <p>3.2. The information and have been provided by the person concerned or to his or her knowledge.</p> <p>4. An obliged entity shall serve a notice under paragraph 1 of this Article as soon as</p>	<p>1.2. ako se desila promena, da izjavi datum promene i da potvrdi ili ispravi tražene podatke koje sadrži obaveštenje, i da pruži svaku informaciju koja nedostaje.</p> <p>2. Relevantna promena u vezi sa licem dešava se ako:</p> <p>2.1. lice prestaje da bude stvarni vlasnik u vezi sa relevantnim registrovanim subjektom, ili</p> <p>2.2. desi se neka druga promena, i kao rezultat toga, obavezni podaci o stvarnom vlasništvu u skladu sa tačkom 1.2 do 1.5 člana 5. ovog zakona, postali su netačni ili nepotpuni.</p> <p>3. Registrovani subjekat nije u obavezi da izdaje obaveštenje u skladu sa stavom 1. ovog člana ako:</p> <p>3.1. je već obavešten o relevantnoj promeni i pruženi su svi podaci iz tačke 1.2 ovog člana, i</p> <p>3.2. dotične lice je dalo informacije i podatke uz njegovo ili njeno znanje.</p> <p>4. Registrovani subjekat treba dostaviti obaveštenje u skladu sa stavom 1. ovog člana</p>
--	--	---

<p>shpejt që të jetë e mundur praktikisht, pasi të mësojë për ndryshimin ose pasi të ketë arsye për të besuar se ndryshimi ka ndodhur.</p> <p>5.Njoftimi sipas nën paragrafit 1 të këtij neni duhet t'ia bëjë me dije të adresuarit se duhet të veprojë në përputhje me njoftimin jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike nga data e njoftimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12</p> <p style="text-align: center;">Obligimi i pronarëve përfitues për të ofruar dhe përditësuar të dhëna për pronarët përfitues</p> <p>1.Pronari përfitues i subjektit të detyruar obligohet të siguroj subjektit të detyruar të gjithë informacionin e nevojshëm brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit nga subjekti i detyruar sipas paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafit 1 të nenit 11 të këtij ligji, në mënyrë që subjektet e detyruara të përmbushin detyrimin ligjor të përcaktuar në paragrafët 1 të nenit 6 dhe paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji.</p> <p>2.Nëse pronari përfitues nuk ka marrë një njoftim nga subjekti i detyruar sipas paragrafit 2 të nenit 8 dhe ai e di, ose arsyeshëm duhet të dijë, se ai është pronar përfitues në lidhje me një subjekt të detyruar dhe të dhënat e tij nuk janë deklaruar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, ai duhet të:</p>	<p>practically possible after becoming aware of the amendment or having reasons to believe that the amendment has occurred.</p> <p>5. The notice under paragraph 1 of this Article shall inform the addressee that he/she must act in accordance with the notice no later than ten (10) calendar days from the date of the notice.</p> <p style="text-align: center;">Article 12</p> <p style="text-align: center;">Obligation of beneficial owners to provide and update data on beneficial owners</p> <p>1. The beneficial owner of the obliged entity shall be required to provide the obliged entity with all necessary information within ten (10) calendar days from the receipt of a notice from the obliged entity, according to paragraph 2 of Article 9 and paragraph 1 of Article 11 of this Law, in order for the obliged entities to fulfill the legal obligation set out in paragraph 1 of Article 6 and paragraph 1 of Article 10 of this Law.</p> <p>2. If a beneficial owner has not received a notice from the obliged entity under paragraph 2 of Article 8 and he/she is aware or reasonably should have been aware that he/she is a beneficial owner in relation to an obliged entity and his/her data is not stated in the Register of Beneficial Owners, he/she shall:</p>	<p>što je brže moguće u praksi, nakon što sazna za promenu ili nakon što ima razloga da veruje da se promena desila.</p> <p>5. Obaveštenje, u skladu sa stavom 1. ovog člana, treba upoznati adresiranog da treba da postupa u skladu sa obaveštenjem najkasnije deset (10) kalendarskih dana od dana obaveštenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 12</p> <p style="text-align: center;">Obaveza stvarnih vlasnika da pružaju i ažuriraju podatke o stvarnim vlasnicima</p> <p>1. Stvarni vlasnik registrovanog subjekta u obavezi je da obezbedi registrovanom subjektu sve potrebne informacije u roku od deset (10) kalendarskih dana od prijema obaveštenja od registrovanog subjekta, u skladu sa stavom 2. člana 9. i stavom 1. člana 11. ovog zakona, kako bi registrovani subjekti ispunili zakonsku obavezu utvrđenu stavom 1. člana 6. i stavom 1. člana 10. ovog zakona.</p> <p>2. Ako stvarni vlasnik nije primio obaveštenje od registrovanog subjekta, u skladu sa stavom 2. člana 8. i on zna, ili razumno treba da zna, da je on stvarni vlasnik u vezi sa registrovanim subjektom i njegovi podaci nisu prijavljeni u Registar stvarnih vlasnika, on treba da:</p>
---	---	---

<p>2.1 njoftojë subjektin e detyruar për statusin e tij si pronar përfitues në lidhje me subjektin përkatës të detyruar;</p> <p>2.2 specifikojë datën në të cilën, sipas njohurive të tij, ai ka fituar atë status, dhe</p> <p>2.3 sigurojë subjektin e detyruar me të gjitha të dhënat e obligueshme të kërkuara për pronarët përfitues.</p> <p>3. Nëse pronari përfitues nuk ka marrë njoftim nga subjekti i detyruar sipas paragrafit 1 të nenit 10 dhe ai e di, ose ka arsye të dijë, se një ndryshim relevant ka ndodhur në të dhënat e tij të obligueshme të regjistruar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, ai duhet të :</p> <p>3.1. njoftojë subjektin e detyruar për ndryshimin përkatës;</p> <p>3.2. specifikojë datën në të cilën, sipas njohurive të tij, ka ndodhur ndryshimi; dhe</p> <p>3.3. sigurojë subjektit të detyruar çdo informacion që kërkohet për të përditësuar të dhënat.</p> <p>4. Detyrimet sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni përmbushen deri në fund të njëzet e një</p>	<p>2.1. notify the obliged entity of his/her status as a beneficial owner related to the relevant obliged entity;</p> <p>2.2. specify the date when, to the best of his/her knowledge, he/she obtained such status, and</p> <p>2.3. provide the obliged entity with all the mandatory data required on beneficial owners.</p> <p>3. If a beneficial owner has not received a notice from the obliged entity under paragraph 1 of Article 10 and he/she is aware or has a reason to become aware that a relevant amendment has occurred in his/her mandatory data recorded in the Register of Beneficial Owners, he/she shall:</p> <p>3.1. notify the obliged entity of the relevant amendment,</p> <p>3.2. specify the date when, to the best of his/her knowledge, the amendment occurred, and</p> <p>3.3. provide the obliged entity with any information required to update the data.</p> <p>4. Obligations referred to in paragraphs 2 and 3 of this Article shall be fulfilled within</p>	<p>2.1. obavesti registrovanog subjekta o njegovom statusu stvarnog vlasnika u vezi sa relevantnim registrovanim subjektom;</p> <p>2.2. naznači datum kada je, prema njegovim saznanjima, on stekao taj status, i</p> <p>2.3. obezbedi registrovanom subjektu sve obavezne podatke koji se traže za stvarne vlasnike.</p> <p>3. Ako stvarni vlasnik nije primio obaveštenje od registrovanog subjekta, u skladu sa stavom 1. člana 10. i on zna, ili ima razloga da zna, da se desila relevantna promena u njegovim obaveznim podacima koji su evidentirani u Registar stvarnih vlasnika, on treba da:</p> <p>3.1. obavesti registrovanog subjekta o relevantnoj promeni;</p> <p>3.2. naznači datum kada se, prema njegovim saznanjima, desila promena; i</p> <p>3.3. obezbedi registrovanom subjektu sve informacije koje se traže za ažuriranje podataka.</p> <p>4. Obaveze u skladu sa stavom 2. i 3. ovog člana ispunjavaju se do kraja dvadeset jednog</p>
--	--	---

<p>(21) ditëve kalendarike duke filluar nga dita kur të gjitha kushtet e përmendura në këto paragrafe janë përmbushur për herë të parë në lidhje me personin.</p>	<p>twenty-one (21) business days, starting from the day when all the conditions referred to in these paragraphs are fulfilled for the first time in relation to the person.</p>	<p>(21) kalendarskog dana počev od dana kada su svi pomenuti uslovi u ovim stavovima po prvi put ispunjeni u vezi sa licem.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI IV</p> <p style="text-align: center;">QASJA NË REGJISTRIN E PRONARVE PËRFITUES, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET LIDHUR ME TË DHËNAT E REGJISTRUARA</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER IV</p> <p style="text-align: center;">ACCESS TO THE REGISTER OF BENEFICIAL OWNERS, RIGHTS AND OBLIGATIONS RELATED TO THE DATA RECORDED</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE IV</p> <p style="text-align: center;">PRISTUP REGISTRU STVARNIH VLASNIKA, PRAVA I OBAVEZE U VEZI SA EVIDENTIRANIM PODACIMA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p style="text-align: center;">Qasja në regjistrin e pronarëve përfitues</p>	<p style="text-align: center;">Article 13</p> <p style="text-align: center;">Access to the Register of Beneficial Owners</p>	<p style="text-align: center;">Član 13</p> <p style="text-align: center;">Pristup registru stvarnih vlasnika</p>
<p>1. Autoritetet kompetente përkatëse do të kenë qasje elektronike pa pagesë, të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në mënyrë që të përmbushin detyrat e tyre ligjore në lidhje me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave për pronarët përfitues.</p> <p>2. Subjektet raportuese mund të marrin informacione mbi të dhënat e regjistruara në regjistër, kur këto të dhëna janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore sipas Ligjit përkatës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimi i Financimit të Terrorizmit ose një ligj tjetër të zbatueshëm.</p> <p>3. Çdo person ose subjekt mund të marrë informacione në lidhje me të dhënat e</p>	<p>1. Competent authorities shall have free of charge, direct and unrestricted electronic access to the data recorded in the Register in order to fulfill their legal duties regarding the inspection of the Register of Beneficial Owners and the collection of data on beneficial owners.</p> <p>2. The reporting entities may receive information on the data recorded in the Register when such data is needed for fulfilling their legal obligations according to the relevant Law on the Prevention of Money Laundering and Combating Terrorist Financing or another applicable law.</p> <p>3. Any person or organization may obtain information related to the data recorded in the</p>	<p>1. Nadležni relevantni organi imaće besplatan, direktan i neograničen elektronski pristup evidentiranim podacima u registar, kako bi ispunili njihove zakonske dužnosti u vezi sa inspeksijskim nadzorom Registra stvarnih vlasnika i prikupljanjem podataka o stvarnim vlasnicima.</p> <p>2. Subjekti izvestioci mogu primiti informacije o evidentiranim podacima u registar, kada su ti podaci potrebni za ispunjavanje njihovih zakonskih obaveza u skladu sa relevantnim Zakonom o sprečavanju pranja novca i borbe protiv finansiranja terorizma ili drugog primenljivog zakona.</p> <p>3. Svako lice ili subjekat može primiti informacije u vezi sa evidentiranim podacima</p>

<p>regjistruara në regjistër, nëse ai person ose subjekt dëshmon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni.</p> <p>4.Të dhënat e pronarëve përfitues të regjistruar në regjistër, të cilat do t'u vihen në dispozicion personave ose subjekteve nga paragrafi 3 i këtij neni, përfshijnë:</p> <p>4.1 emrin dhe mbiemrin e pronarit përfitues;</p> <p>4.2 shtetësinë;</p> <p>4.3 vitin dhe muajin e lindjes;</p> <p>4.4 vendbanimin;</p> <p>4.5 datën e përcaktimit të personit si pronar përfitues;</p> <p>4.6 Natyra dhe shtrirja (e shprehur në përqindje) e interesit përfitues të mbajtur, qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.</p> <p>5.Interesi legjitim - për të pasur qasje në të dhënat e regjistruara në regjistër sipas paragrafit 3 të këtij neni do të përcaktohet përfundimisht, rast pas rasti, nga ARBK. Kriteret për përcaktimin e interesit legjitim përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p> <p>6.Subjektet raportuese ose personat e përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni,</p>	<p>Register if such person can prove a legitimate interest in obtaining the information.</p> <p>4. The data on beneficial owners recorded in the Register that shall be made available to persons or entities under paragraph 3 of this Article shall include:</p> <p>4.1 First and last name of the beneficial owner;</p> <p>4.2 Nationality;</p> <p>4.3 Year and month of birth;</p> <p>4.4 Place residence;</p> <p>4.5 Date of designation of the person as beneficial owner;</p> <p>4.6 Nature and extent (expressed in percentage) of the beneficial interest held, whether direct or indirect.</p> <p>5.A 'legitimate interest' to have access to the data recorded in the Register under paragraph 3 of this Article shall be conclusively determined, on a case by case basis, by the KBRA. The criteria to designate a 'legitimate interest' shall be defined in a bylaw issued the Ministry.</p> <p>6. In order to obtain data on the beneficial owner of a certain obliged entity,</p>	<p>u registar, ako to lice ili subjekat dokaže da ima legitiman interes za prijem ovih informacija.</p> <p>4. Podaci o stvarnim vlasnicima evidentiranih u registar, koji će se staviti na raspolaganje licima ili subjektima iz stava 3. ovog člana, sadrže:</p> <p>4.1 ime i prezime stvarnog vlasnika;</p> <p>4.2 državljanstvo;</p> <p>4.3 godinu i mesec rođenja;</p> <p>4.4 prebivalište;</p> <p>4.5 datum utvrđivanja lica kao stvarnog vlasnika;</p> <p>4.6 prirodu i obim (izražen u procentima) zadržanog korisničkog interesa, bilo direktnog ili indirektno.</p> <p>5.Legitimni interes – pristup evidentiranim podacima u registar, u skladu sa stavom 3. ovog člana, utvrdiće se konačno, od slučaja do slučaja, od strane KARP-a. Kriterijume za utvrđivanje legitimnog interesa utvrđuje ministarstvo podzakonskim aktom.</p> <p>6. Subjekti izvestioci ili lica utvrđena u stavu 2. i 3. ovog člana, kako bi primili podatke o</p>
---	---	---

<p>në mënyrë që të marrin të dhëna për pronarin përfitues të një subjekti të caktuar të detyruar, duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim ose elektronike në ARBK.</p> <p>7.ARBK, pas shqyrtimit të kërkesës dhe konfirmimit se subjekti raportues kërkon qasje në të dhënat në regjistër në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe personi ose subjekti ka interes legjitim për të paraqitur kërkesën për marrjen e të dhënave për pronarët përfitues, sipas paragrafit 6, dhe se nuk ka arsye të mjaftueshme që të mos lejohet qasja në të dhëna të kufizuara, pas verifikimit të pagesës në informacionin e kërkuar, ARBK-ja do t'ua sigurojë të dhënat e kërkuara këtyre subjekteve apo personave raportues brenda dhjetë (10) ditëve të punës.</p> <p>8.ARBK-ja mund të refuzojë kërkesën e cilitdo person ose subjekt të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni për marrjen e të dhënave për pronarët përfitues të një subjekti të detyruar të caktuar nëse të dhënat e tilla mbrohen sipas përjashtimit të dhënë sipas nenit 14 të këtij ligji.</p> <p>9.Rregullat për mënyrën e komunikimit në formë elektronike dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet ARBK-së, autoriteteve kompetente, subjekteve raportuese dhe personave ose subjekteve kërkuese përcaktohen me akt nënligjorë nga Ministria.</p>	<p>the reporting entities or the persons referred to in paragraphs 2 and 3 of this Article, must submit a written or electronic request to KBRA.</p> <p>7.KBRA shall, after reviewing the request and confirming that the reporting entity seeks access to the data in the Register in accordance with paragraph 2 of this Article, and the individual or entity has a legitimate interest in submitting the request for obtaining data on beneficial owners, as per paragraph 6, and there is no sufficient reason to deny access to restricted data, after verifying the payment for the requested information, provide the requested data to these reporting entities or individuals within ten (10) business days.</p> <p>8.KBRA may reject the request of any person or entity specified in paragraph 3 of this Article for obtaining data on beneficial owners of a specific obliged entity if such data is protected by derogation provided for under Article 14 of this Law.</p> <p>9.The rules for electronic communication and data exchange between KBRA, competent authorities, reporting entities, and requesting individuals or entities shall be defined by a bylaw issued by the Ministry.</p>	<p>stvarnom vlasniku određenog registrovanog subjekta, treba da podnesu zahtev KARP-u u pismenom ili elektronskom obliku.</p> <p>7.KARP, nakon razmatranja zahteva i potvrđivanja da subjekat izvestilac traži pristup podacima u registar, u skladu sa stavom 2. ovog člana, i da lice ili subjekat ima legitiman interes da podnese zahtev za prijem podataka o stvarnim vlasnicima, u skladu sa stavom 6. i da nema dovoljnih razloga da se ne odobri pristup ograničenim podacima, nakon verifikacije uplate za tražene informacije, KARP će obezbediti tražene podatke ovim subjektima izvestiocima ili licima u roku od deset (10) radnih dana.</p> <p>8. KARP može odbiti zahtev bilo kog lica ili subjekta utvrđenog u stavu 3. ovog člana za prijem podataka o stvarnim vlasnicima određenog registrovanog subjekta ako su takvi podaci zaštićeni prema izuzeću datom u skladu sa članom 14. ovog zakona.</p> <p>9. Pravila o načinu komunikacije u elektronskom obliku i razmeni podataka između KARP-a, nadležnih organa, subjekata izvestilaca i lica ili subjekata koji podnose zahtev, utvrđuje ministarstvo podzakonskim aktom.</p>
--	--	--

